

KQZ-ja: 88% e votuesve të regjistruar nga diaspora për votim me postë kanë pranuar fletëvotimet



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA VIZITUAR TË ENJTEN NË HAGË
ISH-PRESIDENTIN E KOSOVËS, HASHIM THAÇI

RAMA: KOMANDANTI NË FORMË, ME KARAKTER TË HEKURT. SHPRESOJ NË MBYLLJEN E KËTIJ TEATRI ABSURD TË DREJTËSISË NDËRKOMBËTARE



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në Hagë, duke përcjellë mesazhe mbështetjeje dhe vlerësimi për gjendjen e tij fizike dhe morale. Pas takimit, Rama u shpreh se Thaçi

është në formë të mirë dhe me karakter të hekurt, ndërsa theksoi shpresën që viti i ardhshëm të shënojë përmbylljen e asaj që ai e quajti "teatr absurd të drejtësisë ndërkombëtare"

BE-ja I HEQ MASAT
NDAJ KOSOVËS,
VENDI PRITET TË
PËRFITOJË MILIONA
EURO NË FILLIM TË
2026-s F. 3




SIRIA PAS
ASSADIT
HAPI DYER,
POR EDHE
ÇËSHTJE PËR
KOSOVËN F. 7



ODA AMERIKANE KUNDËRSHTON
KONTROLLIN ADMINISTRATIV
TË ÇMIMEVE NË TREGUN
E KARBURANTEVE F. 8

NË TIRANË NËNSHKRUHET
MARRËVESHJE HISTORIKE PËR
BASHKËPUNIM EKONOMIK
KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR F. 8

SPORT



SUPERKUPA E KOSOVËS ZHVILLOHET
MË 25 JANAR NË ANTALIA F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency
Internet Website,
Marketing...

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA VIZITUAR TË ENJTEN NË HAGË ISH-PRESIDENTIN E KOSOVËS, HASHIM THAÇI

RAMA: KOMANDANTI NË FORMË, ME KARAKTER TË HEKURT. SHPRESOJ NË MBYLLJEN E KËTIJ TEATRI ABSURD TË DREJTËSISË NDËRKOMBËTARE

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në Hagë, duke përcjellë mesazhe mbështetjeje dhe vlerësimi për gjendjen e tij fizike dhe morale. Pas takimit, Rama u shpreh se Thaçi është në formë të mirë dhe me karakter të hekurt, ndërsa theksoi shpresën që viti i ardhshëm të shënojë përmbylljen e asaj që ai e quajti “teatër absurd të drejtësisë ndërkombëtare”

EPOKA E RE Mal QORRAJ

HAGË, 18 DHJETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar të enjten në Hagë ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Rama në një postim në “Facebook” ka njoftuar se e ka gjetur Thaçin në formë, të qetë e të buzëqeshur si çdo i pafajshëm me karakter të hekurt, edhe pse me ndalime absurde të drejtash minimale që i ishin hequr krahasimisht me herën e kaluar. “Sapo kam dalë nga godina ku luhet teatri i turpit të drejtësisë ndërkombëtare me Hashim Thaçin, i cili u rrëmbye pa gjyq e as akuzë nga zyra e Presidentit të Republikës, ku e kishte çuar populli i Kosovës, e me Luftën Çlirimtare të Kosovës, të cilën nuk e përdhos dot një farsë e nisur për trafik organesh nga kukullat ruse të Dumës së Putinit në Strasburg dhe e vazhduar me lloj-lloj absurditetesh e dëshmitarësh groteskë të akuzës ndërkombëtare në Hagë. E kam gjetur komandantin në formë, të qetë e të buzëqeshur



si çdo i pafajshëm me karakter të hekurt, edhe pse me ndalime absurde të drejtash minimale që i ishin hequr krahasimisht me herën e kaluar - një turp më vete me

një fjalë! Kemi folur për familjet, për miqtë e përbashkët, për Shqipërinë e për Kosovën, për “Skënderbeun” e Aurel Plasarit, që ia pata çuar më parë, për librin e fundit të Kisingerit që ia çova këtë herë, e për dy a tre libra të tjerë nga moria e leximeve të tij në këtë vend, të cilin me të qeshur Hashimi e quan ‘institut’”, ka shkruar Rama. Ai ka theksuar se nuk di çfarë të thotë më për këtë padrejtësi ulëritëse në zemër të Evropës. “Nuk di ç’të them më për këtë padrejtësi ulëritëse në zemër të Evropës demokratike, me bekimin e shteteve të Evropës e ShBA-së dhe me fondet e

taksapaguesve evropianë e amerikanë, ndaj një populli evropian që çliroi vetveten nga një regjim nacional-socialist, po edhe Evropën nga një njollë e zezë apartajdi mu në kërthizën e saj për dekada me radhë. Bekuar qofshin Republika e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe të burgosurit e saj pa gjyq, prej më shumë se pesë vjetësh tanimë, në mes të Evropës së lirisë, demokracisë e shtetit ligjor”, ka thënë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Rama vetëm pak minuta para vizitës, ishte deklaruar për opinionin se tashmë ka përfunduar paraqitja e provave të akuzës dhe dëgjimi i

dëshmitarëve dhe ka shprehur besimin se viti i ardhshëm do të shënojë mbylljen e këtij procesi dhe shpalljen e pafajësisë. “Tani që ka mbaruar ekspozimi i pseudo-provave të akuzës dhe parada e dëshmitarëve qesharakë, ndërsa janë dhënë dëshmitë serioze të mbrojtjes, pritet vendimi. Uroj që viti i ardhshëm të jetë viti i mbylljes së këtij teatri absurd të drejtësisë ndërkombëtare”, ka pohuar Rama. Kjo nuk është hera e parë e Ramës që viziton Thaçin në Hagë. Ai ka vizituar edhe disa herë ish-presidentin Thaçi dhe madje ka përcjell mesazhe se ai po mbahet padrejtësisht me çlirimtarët tjerë që pesë vite.

Endrit Thaçi mesazh kryeministrit Rama pas vizitës në Hagë: Faleminderit nga nana dhe unë

Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka reaguar pas vizitës së kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Hagë, ku ai të enjten vizitoi Thaçin. “Faleminderit shumë Kryeministër Rama nga nana dhe unë. Fjalët por edhe veprat e juaja janë shndërruar në shembull të atdhedashurisë dhe përparimit. Ju na dëshmoni se bashkë jemi ma mirë”, shkroi ai në rrjetet sociale.

“Boll me fjalë”, kancelarit Merz i soset durimit: T’i ngrijmë asetet ruse, ta bëjmë fakt

BERLIN, 18 DHJETOR - Kancelari gjerman Friedrich Merz kërkoi hapur ngrirjen 210 miliardë eurove e asete ruse për të ndihmuar në përfundimin e luftës në Ukrainë. Gjatë fjalimit të mbajtur në Bundestag mbi zhvillimet e vitit 2025 që po e lëmë pas, Merz pohoi se në nivelin gjeopolitik, trazirat kanë qenë të thella. Marrëdhënia e

Gjermanisë me ShBA-në ka ndryshuar rrënjësisht, kujtoi ai, në Ukrainë vazhdon lufta e paligjshme agresore e Rusisë, teksa lufrat tregtare kanë rënduar ekonominë gjermane, e cila për shkak të “mosmarrjes së masave në të kaluarën” po has në vështirësi serioze edhe brenda vendit. Ai sheh një shqetësim real se rendi botëror që po zëvendësohet nga

çrregullimi. “Ne nuk mund të qëndrojmë duarkryq dhe të kundrojmë teksa bota riorganizohet. Nuk jemi top loje i superfuqive. Çështja me Ukrainën është sesi të arrihet një paqe e drejtë. Asetet ruse të ngrira në bankat europiane duhet të përdoren për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, ne i dërgojmë një sinjal të qartë Rusisë se do t’i përdorim asetet

e depozituara këtu për të ndihmuar në përfundimin e kësaj lufte sa më shpejt të jetë e mundur”, shprehet Merz. Shumica e 27 qeverive të BE-së e mbështesin përdorimin e afro 210 miliardë eurove të aseteve ruse të bllokuara në BE për të ofruar gjatë viteve të ardhshme ndihmë financiare për Ukrainën si për të mbështetur rindërtimin e vendit edhe për



blerjen e armëve moderne për ushtrinë ukrainase.

BE-ja I HEQ MASAT NDAJ KOSOVËS, VENDI PRITET TË PËRFITOJË MILIONA EURO NË FILLIM TË 2026-s

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Bashkimi Evropian (BE) ka vendosur t'i heqë të gjitha masat ndëshkuese ndaj Kosovës deri në fund të muajit të ardhshëm, duke ia mundësuar vendit të përfitojë miliona euro ndihmë financiare qysh në fillim të vitit 2026, njoftuan zyrtarë nga të dyja palët të mërkurën vonë.

Vendimi vjen pasi u bë kalimi i pushtetit lokal në mënyrë paqësore në veriun e banuar me shumicë serbe, pasi ishin pikërisht tensionet në këtë pjesë të Kosovës që shtynë bllokun të vendoste masa ndëshkuese ndaj saj verën e vitit 2023.

Ishte presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ajo që njoftoi e para se BE-ja vendosi t'i heqë të gjitha masat deri në fund të janarit, gjatë samitit të bllokut me vendet e Ballkanit Perëndimor të mërkurën në Bruksel.

“Gjatë bisedimeve intensive me partnerët tanë u mor vendimi që të gjitha masat t'i hiqen Kosovës, ku një pjesë e madhe i hiqet sot, kurse pjesa tjetër në fund të janarit”, tha Osmani të mërkurën vonë në “Facebook”.

Osmani, e cila e përfaqësoi

Kosovën në samit, shtoi se “rrjedhimisht, edhe fondet do të zhblokohen, një pjesë shumë e madhe menjëherë e një pjesë tjetër në fund të janarit”.

Ndërkohë, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, shkroi më pas në X se BE-ja po i heq masat pasi kalimi i pushtetit lokal në veri pas zgjedhjeve të fundit lokale u zhvillua në mënyrë paqësore.

“Falë kësaj, kam kënaqësinë të njoftoj se po ecim përpara me heqjen e masave ndaj Kosovës”, shkroi ajo.

Ajo shtoi se blloku po planifikon 216 milionë euro ndihmë financiare për Kosovën dhe se synon që t'ia ndajë asaj 205 milionë euro qysh në fillim të vitit 2026.

BE-ja veçse i kishte hequr gjysmën e masave në fillim të kësaj jave, por nuk ishte e qartë se ato do të hiqeshin plotësisht pas një muaji, pasi thuhej se vende si Franca dhe Italia, të mbështetura nga Spanja, Hungaria dhe Sllovakia, nuk kishin vullnet për heqjen e të gjitha sanksioneve.

Zyrtarët në Kosovë kanë kërkuar me këmbëngulësi vazhdimisht



nga BE-ja t'u japë fund masave ndëshkuese, të cilat i shkaktuan vendit dëme në vlera milionëshe.

Ata argumentonin se gjendja në veri ishte shtensionuar tashmë pas zvogëlimit të pranisë së Policisë në ndërtesat komunale, pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet e sivjetshme dhe kalimi i pushtetit tek serbët lokalë në mënyrë paqësore.

Këto masa ndëshkuese i kishin

kushtuar Kosovës rreth 613.4 milionë euro në projekte të pezulluara ose të shtyra për afat të pacaktuar.

Për shkak të kalimit të afateve, 7.1 milionë euro janë humbur tërësisht, sipas një analize të Institutit për Studime të Avancuara - GAP.

Sektorët më të prekur përfshijnë mjedisin, me 350 milionë euro, energjinë me 114 milionë euro, digjitalizimin me rreth 57

milionë euro, dhe kulturën me 15 milionë euro.

Prej këtyre fondeve, rreth 218 milionë euro kanë qenë për projekte në kuadër të Instrumentit para-anëtarësimit (IPA II dhe IPA III), dhe rreth 395 milionë euro për projekte në kuadër të Kornizës për Investime të Bashkimit Evropian për rajonin e Ballkanit Perëndimor (WBIF).

AMBASADA E SHBA-së: SYNOJMË TË PUNOJMË ME QEVERINË E RE PËR AVANCIM TË PRIORITETEVE TË PËRBASHKËTA

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë i tha “Radios Evropa e Lirë” se pas zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit në Kosovë synon të punojë ngushtë me Qeverinë e re të zgjedhur “për t'i avancuar prioritetet e përbashkëta”.

Një zëdhënës i Ambasadës amerikane në Prishtinë tha në disa përgjigje me shkrim për “REL”-in se shpreson që “partneriteti ynë të thellohet me Qeverinë e Kosovës”, përfshirë edhe rinisjen e Dialogut të planifikuar Strategjik.

“Kjo do të kërkojë veprim për të avancuar agjendën tonë të përbashkët për paqe rajonale, stabilitet dhe prosperitet të ndërsjellë ekonomik”, tha zëdhënësi i Ambasadës amerikane.

Ky qëndrim i Ambasadës vjen pas deklaratave të bëra nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti gjatë një interviste në televizionin lokal Kanal 10 se raportet mes dy vendeve janë shumë të mira dhe mospajtimet kryesore gjithmonë kanë qenë lidhur me Serbinë dhe strukturat e saj, dhe asnjëherë për çështje bilaterale.



Më 11 dhjetor, Kurti tha, po ashtu, se sa u përket mbrojtjes dhe sigurisë, raportet “kurrë nuk kanë qenë më të mira”.

Megjithatë, në shtator të këtij viti, ShBA-ja njoftoi për pezullim për një kohë të pacaktuar të Dialogut të planifikuar Strategjik me Kosovën, për shkak të shqetësimeve lidhur me veprimet e Qeverisë në detyrë.

Nga Ambasada amerikane po ashtu thanë se janë të “zhgënjyer nga veprimet” e Kurtit, duke

theksuar se qëndrimet e tij kanë rritur paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në Kosovë.

Dialogu ishte planifikuar që të forconte raportet ekonomike dhe diplomatike, por veprimet e Kurtit u panë si sfida për përparim.

Disa analistë politikë patën komentuar atëbotë se pezullimi ishte paralajmërim se mbështetja ndërkombëtare për Kurtin dhe Qeverinë e tij po zbehet.

Kurti fillimisht kishte pranuar se

ekzistonin disa dallime me ShBA-në, por raportet me Uashingtonin nuk ishin prishur.

Më pas, më 28 shtator tha se arsyeja e pezullimit të Dialogut të planifikuar Strategjik ishte për shkak të sundimit të ligjit në veri të Kosovës, “i cili rezultoi të ishte kundër strukturave ilegale serbe dhe këtu nuk mund të bëj kompromise”.

Dialogu Strategjik, që ShBA-ja zhvillon me shtete të tjera, përfshin diskutime të nivelit të

lartë mes dy vendeve që zhvillohen ose në Uashington, ose në vendin përkatës, mbi një gamë të gjerë temash si mbrojtja, siguria, mjedisi, energjia, bashkëpunimi ekonomik, e të tjera.

Shtetet e Bashkuara i kanë ndarë mbi 2 miliardë dollarë për Kosovën prej vitit 1998.

Uashingtoni konsiderohet si partneri më i rëndësishëm i Kosovës dhe mbështetja e tij vlerësohet jetike për vendin.

Viteve të fundit, Kurti, që është në pushtet që nga fitorja në zgjedhje më 2021, është kritikuar disa herë nga faktori ndërkombëtar për shkak të disa vendimeve në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, që kishin të bënin me zëvendësimin e targave serbe me ato të Kosovës, heqjen nga përdorimi i dinarit serb dhe mbylljen e institucioneve serbe.

Ai ka thënë se këto veprime janë në kuadër të shtrirjes së sundimit të ligjit në veri, duke theksuar se ato janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Megjithatë, ShBA-ja dhe qendrat evropiane i kanë cilësuar shpesh këto si veprime të njëanshme dhe të pakoordinuara.



SIRIA PAS ASSADIT HAPI DYER, POR EDHE ÇËSHTJE PËR KOSOVËN

Qytetarët që iu bashkuan grupit militant Shteti Islamik në Siri mbeten një sfidë ligjore dhe sigurie, ku riatdhesimi, ndjekja e ligjit dhe programet e deradikalizimit janë thelbësore për sigurinë kombëtare dhe integritimin e tyre, thonë ekspertët. Rënia e regjimit të Assadit dhe ardhja e Ahmed al-Sharaas si lider tranzicioni kanë ndryshuar rrjedhën politike në Siri, duke hapur mundësi për marrëdhënie diplomatike të reja me Kosovën, por edhe për trajtimin institucional të çështjeve të ndjeshme. Në Siri, përndryshe, ka edhe një komunitet shqiptar, i njohur si “arnaout”, e që pret mbështetje institucionale, kulturore dhe arsimore nga autoritetet e reja

Damasku, 18 dhjetor - Lufta që shpërtheu në Siri në vitin 2011 nuk mbeti një krizë e largët për Kosovën. Ajo u shndërrua shpejt në një sfidë konkrete sigurie dhe politike, me pasojë që u ndjenë drejtpërdrejt edhe në Prishtinë. Konflikti, i cili nisi si kryengritje kundër regjimit të Bashar al-Assadit dhe më pas u shndërrua në arenë përplasjesh rajonale e globale, tërhoqi edhe qindra qytetarë të Kosovës.

Rreth 400 syresh - burra, gra dhe fëmijë - udhëtuan drejt Sirisë për t’iu bashkuar grupit militant Shteti Islamik, i cili, përkrah aktorëve të tjerë të armatosur, luftonte për rrëzimin e regjimit të Assadit.

Fenomeni i luftëtarëve të huaj e vuri Kosovën përballë rreziqeve serioze të radikalizimit dhe sigurisë, duke e detyruar shtetin të ndërhynte institucionalisht.

Në vitin 2015, autoritetet miratuan ligjin që ndaloi dhe sanksionoi pjesëmarrjen e qytetarëve kosovarë në luftëra të huaja, përfshirë atë në Siri. Shteti Islamik u mposht ushtarakisht në vitin 2019. Që nga ajo kohë, një pjesë e shtetasve të Kosovës u riatdhesuan dhe u trajtuan në përputhje me legjislacionin në fuqi; të tjerë humbën jetën në luftime, ndërsa një numër mbetet ende në Siri.

Sot, realiteti politik i këtij vendi është rrënjësisht ndryshe. Regjimi më shumë se dydekadësh i Assadit u rrëzua në fund të vitit të kaluar dhe pushtetin e mori Ahmed al-Sharaa - ish-figurë e lidhur me lëvizjet xhihadiste, i cili tani pozicionohet si lider tranzicioni, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Turqisë

dhe vendeve të Bashkimit Evropian.

Në këtë realitet të ri, Siria në fund të tetorit e njohu shtetësinë e Kosovës, duke hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet mes dy vendeve.

Por kjo njohje, përveç mundësive diplomatike, riktheu në vëmendje edhe një sërë pyetjesh të ndjeshme: çfarë do të ndodhë me shtetasit e Kosovës që iu bashkuan Shtetit Islamik dhe që ende ndodhen në Siri, dhe a do të bëhet kjo çështje pjesë e agjendës së ardhshme dypalëshe mes Prishtinës dhe Damaskut?

Radio Evropa e Lirë ia drejtoi këto pyetje si Qeverisë së re të Sirisë, ashtu edhe Zyrës së Presidentes së Kosovës, e cila e pranoi zyrtarisht njohjen nga Damasku, por, edhe pas gati një javë pritjeje, nuk mori përgjigje nga asnjëra palë.

REL-i, përmes burimeve të veta, u përpoq të kontaktonte edhe disa shtetas kosovarë në Siri, por pa sukses.

Qartësi ligjore, dilema politike

Arianit Shehu, drejtor ekzekutiv i Qendrës Amerikane për Luftimin e Ekstremizmit dhe Terrorizmit, vlerëson se çështja e luftëtarëve të huaj nga Kosova që kanë shkuar në Siri, duhet të trajtohet me qartësi të plotë ligjore dhe përgjegjësi shtetërore.

Sipas tij, çdo qytetar i Kosovës që ka marrë pjesë në konflikte të huaja duhet, në rast kthimi, t’i nënshtrohet pa përjashtim legjislacionit të Republikës së Kosovës për luftëtarët e huaj. “Respektimi i ligjit është parakusht për sigurinë kombëtare, sundimin e ligjit dhe besueshmërinë e institucioneve të shtetit, si dhe për mbrojtjen e shoqërisë nga rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, thekson Shehu për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se trajtimi i këtyre rasteve duhet të jetë i drejtë dhe profesional, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke kombinuar drejtësinë penale me programe të deradikalizimit dhe

riintegrimin, aty ku kjo është e mundur.

Një këndvështrim më diplomatik ofron Albert Prenkaj, ish-ambasador i Kosovës në Itali. Ai thekson se autoritetet e Kosovës asnjëherë nuk ua kanë ndaluar kthimin në vend luftëtarëve të huaj, por se në të gjitha rastet ata janë trajtuar në bazë të ligjeve në fuqi.

Sipas Prenkajt, në Siri, luftëtarët e huaj me origjinë nga Kosova shpesh perceptohen si individë që kanë kontribuar në rrëzimin e regjimit të Assadit.

Megjithatë, ai vlerëson se çdo rol eventual i tyre në ndërtimin e një shoqërie demokratike në Siri, duhet të shoqërohet me transformim të ideve dhe shkëputje nga bindjet radikale.

Ai thekson se bëhet fjalë për një numër relativisht të vogël individësh dhe shfaq shpresën se udhëheqja e re siriane, me konsolidimin e institucioneve demokratike, do të mund të luajë rol në rehabilitimin e pozitës së tyre. “Unë besoj se, nëse Ahmed al-Sharaa arrin të konsolidohet si president në një Siri me institucione demokratike, ai do ta ketë edhe përgjegjësinë të ndihmojë në rehabilitimin e këtyre qytetarëve - shqiptarëve nga Kosova”, thotë Prenkaj për Radion Evropa e Lirë.

RRËMUJË NË KUVENDIN E SHQIPËRISË MES AKUZAVE PËR KORRUPSION NDAJ ZËVENDËSKRYEMINISTRES BALLUKU

TI RANË, 18 DHJETOR - Deputetët e opozitës u përleshën me policinë brenda sallës së Kuvendit të Shqipërisë të enjten, pas tensioneve disajvore lidhur me akuzat për korrupsion ndaj zëvendëskryeminstres, Belinda Balluku dhe zyrtarëve të tjerë. Deputetët ndezën flakadanë, hodhën ujë drejt kryetarit të Kuvendit dhe i zunë vendet e ministrave të Qeverisë, në një përpjekje për të ndërprerë seancën, përpara se të ndërhynte policia. “Nuk mund të ketë Kuvend me ata zbatojnë moton vidh dhe ik”, tha Sali Berisha, kreu i Partisë Demokratike në opozitë. “Ligji, ligji dhe vetëm ligji duhet të mbizotërojë”, shtoi ai për media pas seancës. Deputetët e opozitës kërkonin të shihnin akuzat zyrtare të paraqitura kundër zëvendëskryeminstres Balluku. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) i ka kërkuar Kuvendit t’ia heqë imunitetin Ballukut dhe ta autorizojë

arrestimin e saj. Kuvendi, ku shumicën e ka partia në pushtet e kryeministrit Edi Rama, pritet të votojë për kërkesën e SPAK-ut të premten. Ndaj Ballukut, e cila njëherësh është edhe deputete dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, SPAK-u ngriti aktakuzë më 31 tetor të këtij viti, nën dyshimet se ka bërë shkelje gjatë dhënies së tenderëve. Balluku i ka mohuar akuzat si “hedhje balte, insinuata, gjysmë të vërteta dhe gënjeshtër”, dhe tha se do të bashkëpunonte plotësisht me drejtësinë. Ajo ishte pezulluar nga detyrat zyrtare dhe i ishte pamundësuar largimi nga shteti, por vendimi i SPAK-ut për pezullim u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese. Rama tha se pas vendimit të Kushtetueses, tani SPAK-u po kërkon autorizim për arrestimin e Ballukut, qoftë për ta dërguar në burg apo në arrest shtëpiak. Ai tha se “arrestet pa gjyq” janë bërë “modë e vrazhdë në Shqipëri”, por shtoi se nuk mund ta paragjykojë kërkesën në fjalë.



Sipas tij, rehabilitimi nënkupton edhe integrimin e tyre në shoqërinë siriane, duke pasur parasysh se shumica tashmë kanë krijuar familje dhe jetë të qëndrueshme në Siri. Historiani Muhamed Mufaku, shtetas i Kosovës, i lindur në Damask dhe anëtar i jashtëm i Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Kosovës, thotë se, aktualisht, në Siri ndodhen vetëm disa dhjetëra luftëtarë të huaj me origjinë nga Kosova. Sipas informacioneve që ai ka, askush prej tyre nuk synon kthimin në vendin e origjinës. “Derisa këto ligje ekzistojnë në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, ata praktikisht nuk mund të kthehen. Këtu janë pritur mirë, disa janë martuar me gra siriane, janë vendosur, kanë pozita dhe kushte të mira jetese... Edhe kjo, në njëfarë mënyre, është një zgjidhje”, thotë Mufaku për Radion Evropa e Lirë. Ai pret që qasja ndaj trajtimit të luftëtarëve të huaj nga vendet e origjinës të ndryshojë, duke pasur parasysh raportet e reja që Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane kanë ndërtuar me udhëheqjen e re siriane. Sipas Mufakut, fakti që presidenti aktual i Sirisë, Ahmed al-Sharaa - i cili dikur ndiqej nga SHBA-ja si udhëheqës i një organizate terroriste - tashmë ka vizituar edhe Shtëpinë e Bardhë, dëshmon për ndryshime të thella në qëndrimet amerikane. “I gjithë realiteti po ndryshon për 180 shkallë. Në këtë ambient të ri politik, edhe luftëtarët e huaj e kanë të qartë se Siria nuk është më terren për ndërtimin e një shteti islamik”, thotë Mufaku. Ai shton se Siria po shndërrohet nga një vend tradicionalisht

anti-amerikan në një shtet gjithnjë e më pro-amerikan - zhvillim ky që, sipas tij, pritet të ndikojë edhe në raportet me aleatët e SHBA-së, përfshirë Kosovën.

Komuniteti shqiptar në Siri

Luftëtarët e huaj nga Kosova nuk janë të vetmit shqiptarë që jetojnë në Siri. Në këtë vend ekziston prej dekadash një komunitet shqiptar, i njohur me emërtimin “arnaout” - një etnonim i përdorur për shqiptarët që nga periudha e Perandorisë Osmane. Pas shpërbërjes së kësaj perandorie në vitin 1922, gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, por edhe pas Luftës së Dytë Botërore, disa mijëra shqiptarë nga Ballkani u zhvendosën drejt Sirisë, duke krijuar një komunitet të qëndrueshëm dhe të integruar në shoqërinë vendase. Sipas historianit Mufaku, komuniteti shqiptar në Siri sot përbëhet nga rreth 8.000 persona. Shumica janë shqiptarë me origjinë nga Kosova, por edhe nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Përthi gjysma e tyre jeton në Damask, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në disa qytete të vendit. Gjatë luftës civile, e cila shpërtheu në vitin 2011 dhe zgjati rreth 15 vjet, edhe ky komunitet u godit rëndë. Në mesin e mijëra viktimave siriane ishin edhe dhjetëra shqiptarë, ndërsa disa qindra të tjerë u detyruan të largohen, kryesisht drejt Turqisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian. Mufaku thotë se komuniteti shqiptar e priti me shpresë dhe gëzim rrëzimin e regjimit të Assadit, duke e parë atë si

mundësi për përmirësim të pozitës së tij në një Siri të re. “Kryetari i ri sirian, Ahmed al-Sharaa, erdhi në pushtet falë formacioneve ushtarake që i qëndruan besnike dhe luftuan me të dhe për të. Në mesin e tyre ka pasur edhe një formacion shqiptar. Në anën tjetër, që nga dita e parë, zëdhënësja e udhëheqjes së re ishte një “arnaoute”, Obaida Arnaout”, thotë Mufaku. Sipas tij, komuniteti shqiptar pret që këto lidhje dhe ky rol të reflektohen në trajtimin institucional nga pushteti i ri sirian. “Shpresat janë të mëdha, por ende jemi në pritje. Siria është në tranzicion dhe duhet kohë për të parë se si shqiptarët do të përfitojnë realisht nga kjo liri e re”, shton ai. Shehu, drejtor ekzekutiv i Qendrës Amerikane për Luftimin e Ekstremizmit dhe Terrorizmit, i cili ka vizituar më herët Damaskun, vlerëson se komuniteti shqiptar në Siri ka qenë për vite me radhë i harruar dhe i marginalizuar - shpesh jashtë çdo vëmendjeje institucionale. Megjithatë, sipas tij, shqiptarët në Siri kanë arritur të ruajnë gjuhën, traditat, zakonet dhe ndjenjën e përkatësisë kombëtare, pavarësisht rrethanave të vështira. “Për këtë arsye, është detyrim moral dhe kombëtar që institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë të ndërmarrin hapa seriozë dhe të koordinuar për mbështetje institucionale, kulturore, arsimore dhe konsullore, në mënyrë që shqiptarët e Sirisë të mos mbeten një kapitull i harruar, por një pjesë e gjallë dhe e mbrojtur e kombit shqiptar”, thekson Shehu.

“Durim” dhe “kujdes” në ndërtimin e marrëdhënieve diplomatike

Trajtimi i çështjes së komunitetit shqiptar në Siri, ashtu si edhe i luftëtarëve të huaj me origjinë nga Kosova, lidhet ngushtë me vendosjen e marrëdhënieve bilaterale dhe diplomatike ndërmjet Prishtinës dhe Damaskut. Vëzhguesit e zhvillimeve në Kosovë dhe Lindjen e Mesme vlerësojnë se vendosja e marrëdhënieve diplomatike është një hap i natyrshëm, por që kërkon kohë, maturi dhe koordinim të kujdesshëm. “Të dyja vendet duhet të jenë të durueshme në këtë proces”, thotë Mufaku. Sipas tij, si Kosova, ashtu edhe Siria po përballen me sfida të brendshme serioze. Kosova është e përfshirë në procese të brendshme politike, përfshirë ato zgjedhore, ndërsa Siria ndodhet në një tranzicion të thellë shtetëror. “Presidenti i ri, Ahmed al-Sharaa, po përpiqet të mbajë një ekuilibër të kujdesshëm mes Lindjes dhe Perëndimit”, thotë Mufaku, duke shtuar se nuk pret që çështjet më delikate diplomatike mes Kosovës dhe Sirisë të trajtohen së paku edhe dy deri në tre vjet. Ish-ambasadori Prenkaj vlerëson se vetë fakti që dy vendet e kanë njohur njëra-tjetrën, përbën një sinjal të qartë për gatishmërinë e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Por, sipas tij, Kosova duhet të tregojë kujdes të veçantë në planifikimin e këtyre raporteve, duke marrë parasysh

koordinimin e vazhdueshëm me aleatët e saj kryesorë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian. “Sa herë që Kosova ka vendosur marrëdhënie bilaterale, kjo është bërë në koordinim me SHBA-në dhe në përputhje me politikat e saj të jashtme dhe të sigurisë, si dhe me politikat e Bashkimit Evropian”, thotë Prenkaj, duke shtuar se Kosova nuk ka nevojë të ngutet në këtë proces. Në të njëjtën linjë shprehet edhe Shehu, i cili vlerëson se ecja drejt vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Sirinë duhet të bëhet me maturi dhe vizion strategjik, në koordinim të plotë me SHBA-në dhe partnerët evropianë. “Një qasje e tillë do t’i mundësonte Kosovës që çështjet e ndjeshme - nga pozita e komunitetit shqiptar në Siri, te siguria, aspektet ligjore dhe interesat ekonomike - të adresohen në mënyrë institucionale dhe të strukturuar brenda një kornize bilaterale”, thekson Shehu. Në përvjetorin e parë të rrëzimit të regjimit të Bashar al-Assadit, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dërgoi një mesazh urimi përmes një video-incizimi me rastin e Ditës së Çlirimit të Sirisë. “Të dashur miq në Siri, ju lutem dini se Kosova është me ju. Ne do të jemi partneri juaj, miku juaj dhe aleati juaj në çdo hap të rrugës...”, tha ndër të tjera Osmani. Vëzhguesit e konsiderojnë këtë mesazh si një sinjal pozitiv në drejtim të ndërtimit të raporteve me Sirinë, megjithatë, nuk është e qartë nëse tashmë ka nisur ndonjë formë e komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet dy palëve.

ZRrE-ja vendos ta zbatojë vendimin e Supremes për liberalizimin e tregut të energjisë

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka vendosur të zbatojë vendimin e Gjykatës Supreme, e cila shpalli të paligjshëm dhe shfuqizoi dy nene të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike. Në mbledhjen e mbajtur të etjen, ZRrE-ja theksoi se vendimi i Supremes ka karakter deklarativ dhe konstativ, dhe nuk krijon apo shfuqizon të drejta apo detyrime të reja për konsumatorët apo pjesëmarrësit në treg. Ushtruesi i detyrës në Departamentin Ligjor në ZRrE, Ymeridin Misini, tha se Udhëzuesi i shfuqizuar, sipas

gjykatës, nuk ka efekt retroaktiv dhe nuk ndikon në marrëdhëniet juridike të bazuara në legjislacionin aktual. “Gjykata Supreme me aktgjykim ka bërë interpretim të detyrueshëm të nenit 37, në lidhje me nenin 3, paragrafi 1.72 të Ligjit për Energjinë Elektrike, në përputhje me nenin 3, duke e sqaruar se e drejta për shërbime universale u takon konsumatorëve familjarë dhe vetëm ndërmarrjeve të vogla që i plotësojnë kriteret ligjore për numrin e punonjësve dhe qarkullimin vjetor. ZRrE-ja vazhdon zbatimin e ligjit për energjinë elektrike, ashtu si

është interpretuar nga Gjykata Supreme, pa zgjerim dhe pa përkufizim përtej kriterëve të përcaktuara. Ky vendim është deklarativ dhe konstatues të natyrës, dhe nuk krijon, ndryshon apo shfuqizon të drejta apo detyrime të reja për konsumatorët apo për pjesëmarrësit në treg. Ky vendim nuk ka efekt retroaktiv dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e marrëdhënieve juridike të detyruara bazuar në legjislacionin në fuqi. Ky konstatim bëhet vetëm për qëllim të qartësimit institucional dhe transparencës juridike pa krijuar efekte të reja normative,” tha ai.



Kryesuesi i bordit të ZRrE-së, Ymer Fejzullahu, tha se vendimi me 5 vota për asnjë kundër konfirmim zbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme

për udhëzuesin, i cili ishte shfuqizuar që nga viti 2021, por tani është konstatuar edhe përmes pezullimit të dy neneve specifike.

KOMUNAT NË VERI TËRHIQEN NGJA ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Ky vendim vjen pasi Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës që mbështetet nga Serbia - e riktheu pushtetin në këto katër komuna pas zgjedhjeve lokale të tetorit

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Komunitet me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku - janë tërhequr nga Asociacioni i Komunave të Kosovës të enjten, pasi duan të jenë pjesë e një asociacioni të veçantë të komunave me shumicë serbe në vend. Ky vendim vjen pasi Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës që mbështetet nga Serbia - e riktheu pushtetin në këto katër komuna pas zgjedhjeve lokale të tetorit. Kryetarët e rinj nga kjo parti kishin paralajmëruar në fillim të dhjetorit se do t'i rishikonin vendimet e marra nga kryetarët e deriatëhershëm shqiptarë. Ata paralajmëruan një “shqyrtim të hollësishëm të gjendjes së trashëguar juridike dhe financiare, në mënyrë që në periudhën e ardhshme të merren vendime në përputhje me ligjin dhe në interesin më të mirë të qytetarëve”. Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, Millan Radojeviq, duke



arsyetuar kërkesën për t'u tërhequr nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, tha se kjo kurrë nuk ka qenë dëshirë e popullsisë serbe në këtë komunë dhe se bëhej fjalë për një “vendim politik”. Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku u udhëhoqën nga kryetarë shqiptarë nga maji i vitit 2023 deri në zgjedhjet e tetorit 2025, pasi përfaqësuesit e Listës Serbe kishin dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022, si pjesë e nismës së përbashkët të serbëve për t'i braktisur institucionet e Kosovës

në shenjë kundërshtimi ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës. Nën udhëheqjen e kryetarëve shqiptarë, këto komuna iu bashkuan Asociacionit të Komunave të Kosovës verën e vitit 2023. Ky asociacion vepron si organizatë joqeveritare me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe mbrojtjes së interesave të anëtarëve të saj. Lista Serbe e kishte kundërshtuar asokohe anëtarësimin e komunave me shumicë serbe në të, duke vlerësuar se vendimi nuk

ishte marrë “në dobi të qytetarëve dhe ishte i paligjshëm”. Asokohe pati reaguar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke vlerësuar se komunitet me shumicë serbe duhet të ishin pjesë e një asociacioni të komunave me shumicë serbe, për theelimin e të cilit Kosova dhe Serbia u pajtuan disa herë gjatë dialogut të tyre nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Kosova nuk ka bërë hapa për ta themeluar këtë asociacion, me gjithë trysninë nga bashkësia ndërkombëtare. Gjatë qeverisjes së tyre në komunitet me shumicë serbe, kryetarët shqiptarë gjithashtu morën në administrim objektet në pronësi të tyre ku funksiononin institucionet serbe, ndaluan ndërtimet që i quanin të jashtëligjshme të financuara nga Serbia, si dhe paralajmëruan rrënimin e vendbanimeve të ndërtuara pa leje. Po ashtu, komuna e Mitrovicës së Veriut, verën e këtij viti, nënshkroi memorandum mirëkuptimi me

komunitetin e Mitrovicës së Jugut, i cili parashikoi ndërtimin e urave mbi lumin Ibër për këmbësorë dhe automjete, gjë që u mbështet nga Qeveria e Kosovës. Lista Serbe ka paralajmëruar se do të kërkojë rishikimin e të gjitha këtyre vendimeve. Ligji për vetëqeverisjen lokale parasheh që, për një vendim ose akt tjetër të komunës që nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, mund të kërkohej rishqyrtim nga organi mbikëqyrës - në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ose institucione të tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës. (REL)

Kryetarët e zgjedhur të kuvendeve komunale

Në seancën e parë të rregullt më 18 dhjetor, në Mitrovicë të Veriut për kryetar të kuvendit komunal u zgjodh Nemanja Bisevac, në Zveçan Sërshan Millosavljeviq, në Leposaviq Marko Rakiq, ndërsa në Zubin Potok Nemanja Jakshiq.

Senati miraton propozimet për rrimërim dhe avancime të personelit akademik në tetë fakultete të UP-së

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Gjatë mbledhjes së Senatit, u miratuan propozimet për rrimërim dhe avancim të personelit akademik në Fakultetin e Arteve, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Edukimit, Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore dhe Fakultetin Filozofik. Senatorët miratuan edhe konkurset për pozitë e personelit

akademik në Fakultetin Filozofik, dy nga të cilat me propozim të rektorit. U rishqyrtuan dhe miratuan edhe pozitë e reja të nevojshme të mësimdhënies në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit. Kështu, Universiteti i Prishtinës vazhdon shpalljen e konkurseve për personelin akademik dhe pritet që edhe konkurset e mbetura në disa njësi akademike të shpallen sa më parë. Senati miratoi njëzëri emërimin e dy profesorëve në Degën e Ballkanistikës të Fakultetit të Filologjisë, për të cilët ishte

shpallur konkurs në shtator të vitit 2025. Në Senat u shty për mbledhjen e radhës shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për punën e Komisionit për Çështje Statutare të Universitetit të Prishtinës, ndërsa u ratifikuan dhe aprovuan disa tema doktorate pas miratimit nga Këshilli Qendror i Studimeve të Doktoratës. Senatorët anuluan një vendim të mëhershëm në lidhje me një titull për një profesor emeritus të UP-së, për mospërmbushje të obligimeve, derisa u miratua



edhe vendimi i Këshillit të Etikës që një profesori tjetër t'i mohohet për një vit mentorimi i temave në të gjitha nivelet e studimeve. Me këtë rast, rektori Arben Hajrullahu ftoi gjithë

komunitetin akademik në UP e përtej që të iniciojnë propozimet për titujt profesor emeritus e titujt e tjerë, të paraparë e bazuar në rregulloren gjegjëse në fuqi. Mbledhja e dhjetorit e Senatit ishte e fundit për vitin 2025.

PENSIONISTËT NUK OBLIGOHEN MË TË DËSHMOJNË SE JANË GJALLË PËR T'I MARRË PENSIONET

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Gjykata Supreme ka shpallur të paligjshme dhe i ka shfuqizuar nenet e një udhëzimi administrativ që obligonte pensionistët të paraqiteshin në departamentin për pensione për të dëshmuar se janë gjallë, ose në të kundërtën përballeshin me humbje të pensione.

Supremja tha se ka pranuar kërkesën e paditësit E.Sh., ndaj Ministrisë së Financave dhe Transfereve, Departamentit të Pensioneve.

Sipas gjykatës, paragrafët në udhëzimin administrativ për procedurat e lajmërimit, suspendimit dhe pagesat dhe kthimin e mjeteve në rastet e keqpërdorimit të pensione, që parashihnin pasoja për pensionistët, siç është ndalja e pensione, nuk janë në harmoni me ligjin.

Supremja tha se i takon

Ministrisë që të monitorojë dhe identifikojë nëse një pensionist ka vdekur. “Nëse pensionisti nuk lajmërohet siç është përcaktuar, Ministria obligohet që të monitorojë burimet ekzistuese të informatave me qëllim të identifikimit të pensionistëve që kanë vdekur. Pra, përgjegjësia e parë për verifikimin e statusit të jetës së pensionistit është e vetë organit publik dhe jo e qytetarit. Kjo dispozitë krijon detyrimin që Ministria të shfrytëzojë çdo mekanizëm administrativ dhe çdo burim zyrtar të informatave përpara se të ndërmarrë masa kufizuese ndaj pensionistit. Ligji ka paraparë një mekanizëm që mbështetet në verifikim aktiv nga ana e Ministrisë dhe jo në barrë disproporcionale ndaj pensionistit”, tha Supremja.

Në aktgjykimin për këtë rast thuhet se suspendimi i pagesës së pensionit duhet të jetë masa e fundit dhe jo e para. “Për këtë



arsye, gjykata konstaton se dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 05/2015, të cilat e trajtojnë moslajmërimin si shkak të domosdoshëm për suspendim dhe i shoqërojnë me pasoja materiale të pakthyeshme, janë të kundërligjshme. Ligji ka paraparë një mekanizëm që

mbështetet në verifikim aktiv nga ana e Ministrisë dhe jo në barrë disproporcionale ndaj pensionistit”.

Sipas vendimit, Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti nuk ka asnjë element që i japin kompetenca Ministrisë që të krijojë afate materiale, të vendosë humbje të pensione

ose të ndryshojë statusin e përfituesit në rast moslajmërimi. Deri më tani, pensionistët janë obliguar që çdo gjashtë muaj të paraqiten fizikisht në Departamentin për Pensione për të dëshmuar se janë gjallë dhe për të mos humbur pensionet.

Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha se ky vendim i Supremes është “jashtëzakonisht i rëndësishëm” pasi barra e verifikimit nuk mund t’u ngarkohet qytetarëve. “Çfarë hapi i madh për mbrojtjen e të drejtave sociale, sigurinë juridike dhe parimin se suspendimi i pensionit duhet të jetë masa e fundit, jo e para”, shkroi ai.

Pensioni i moshës në Kosovë është 150 euro, ndërkaq pensioni kontributpagues, aktualisht, sillet nga 218 deri në 318 euro në muaj, varësisht nivelit të arsimimit.

KQZ-ja: 88% E VOTUESVE TË REGJISTRUAR NGA DIASPORA PËR VOTIM ME POSTË KANË PRANUAR FLETËVOTIMET

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pothuajse ka arritur të dërgojë të gjitha paket me fletëvotime për votuesit jashtë Kosovës që janë regjistruar të votojnë përmes postës në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një përgjigje me shkrim për “Gazeta Express” ka treguar të dhënat e fundit nga ky proces, i cili, sipas tij, është duke u kryer nga KQZ, përmes operatorit ekonomik.

Sipas tij, nga dita martë në mëngjes kur ka filluar shpërndarja e tyre dhe deri të mërkurën në mesnatë, janë shpërndarë 88% e pakove me fletëvotime. “Sipas raportit që kemi pranuar, deri më 17 dhjetor 2025 (ora 23:00), nga gjithsej 57,829 dërgesa, 88% e tyre apo 50,611, janë dorëzuar me sukses te votuesit. Nga numri i përgjithshëm i dërgesave, 48.870 (90%) janë dorëzuar te votuesit në shtete në Evropë, ndërkaq, 2,141 dërgesa (51%) janë dorëzuar te



votuesit në shtete jashtë Evropës”, tha Elezi.

Elezi ka treguar se këto statistika do të ishin edhe më të larta, nëse do të dorëzoheshin me sukses edhe 1,941 pakot tjera, por që kjo s’ka ndodhur për shkak se votuesit nuk ndodheshin në shtëpi. “Në 1,941 raste, dërgesat nuk janë dorëzuar për shkak se votuesit nuk kanë qenë në shtëpi në momentin e dorëzimit të pakos me fletëvotim. Sipas kontratës, është detyrë e operatorit ekonomik që dorëzimin e zarfit ta kryejë tek adresa e votuesit dhe mund të pranohet vetëm nga votuesit ose familjarët, të cilët e nënshkruajnë pranimin e dërgesës. Po ashtu, sipas kushteve të kontratës, në adresë të një votuesi, do të shkohet deri në 3 herë për t’ia dorëzuar pakon me fletëvotim”, tha Elezi.

Sipas Elezit, procesi i dërgimit është duke vazhduar dhe për këtë, KQZ ka miratuar më herët afatet për përgatitjen, nisjen dhe dërgimin e pakove në

adresë të votuesve të regjistruar. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar afatet për përgatitjen, nisjen dhe dërgimin e pakove me fletëvotime për votuesit e regjistruar për votim përmes postës. Këto afate janë pjesë përbërëse e kontratës së arritur me operatorin ekonomik. Sipas planifikimeve, arritja e fletëvotimeve për votuesit në Evropë planifikohet të bëhet nga data 16 deri më 18 dhjetor, ndërkaq për votuesit që ndodhen në shtetet janë Evropës nga 17 deri më 19 dhjetor”, tha Elezi.

Sipas KQZ-së, me qëllim të ofrimit të mundësisë për votim për shtetasit që janë regjistruar për të votuar përmes postës, kutitë postale janë funksionale në këto 23 shtete: Australi, Austri, Belgjikë, Çeki, Danimarkë, Francë, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kanada, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Mbretëria e Bashkuar, Norvegji, ShBA, Shqipëri, Slloveni, Suedi, Turqi dhe Zvicër.

FSK-ja realizon Forumin e Nënoficerëve

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Forca e Sigurisë së Kosovës ka realizuar “Forumin e Nënoficerëve të FSK-së”, me qëllim fuqizimin e bashkëpunimit profesional dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet nënoficerëve dhe oficerëve të rinj.

Hapjen zyrtare të forumit e bëri Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, i cili theksoi rëndësinë e rolit të nënoficerëve në ndërtimin e një force profesionale duke qenë

shtylla kryesore për realizimin e detyrave dhe misionit të FSK-së. Forumi u udhëhoq nga rreshter majori i FSK-së Bedri Zuka, i cili ritheksoi përkushtimin e tij dhe të nënoficerëve në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së në të gjitha nivelet.

Gjithashtu gjatë këtij forumi u potencua rëndësia e ndikimit të bashkëpunimit me Gardën e IOWA-s në zhvillimin dhe edukimin profesional të nënoficerëve të FSK-së.

Në këtë forum pjesëmarrës ishin nënoficerë të FSK-së nga të gjitha nivelet ku patën mundësi të diskutonin tema të ndryshme mbi zhvillimin e korit të nënoficerëve, ndërtimin e besimit dhe fleksibilitetit në udhëheqje, marrëdhëniet në mes të nënoficerëve dhe oficerëve etj. Pjesë e këtij forumi ishin edhe përfaqësues nga Ambasada e ShBA-së, Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Garda Kombëtare e AJOV-ës, NALT, ASG Ballkan etj.



FSK është e përkushtuar në ngritjen dhe zhvillimin e mëtejme të korit të nënoficerëve si shtylla

kryesore e forcës për kryerjen me sukses misionit kushtetues dhe ligjor.

ODA AMERIKANE KUNDËRSHTON KONTROLLIN ADMINISTRATIV TË ÇMIMEVE NË TREGUN E KARBURANTEVE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka shprehur kundërshtimin e saj të fuqishëm lidhur me vendimin e fundit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vendosjen e masave administrative që përcaktojnë marzha maksimale tregtare për produktet e naftës. Oda Amerikane ka rikujtuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton një ekonomi të tregut me konkurrencë të lirë, duke e kufizuar ndërhyrjen e shtetit në përcaktimin e çmimeve vetëm në rrethana rreptësisht të përcaktuara dhe përjashtimore. Çmimet e karburanteve nuk janë çmime të rregulluara sipas kornizës ligjore të Kosovës dhe

përcaktimi i tyre përmes akteve administrative përbën ndërhyrje të drejtpërdrejtë në një treg përndryshe të lirë. Sipas kësaj ode, një ndërhyrje e tillë cenon parimet themelore kushtetuese të lirive ekonomike, sigurisë juridike dhe konkurrencës së lirë, si dhe krijon një precedent shqetësues për përfshirje diskrecionale të shtetit në tregjet ku çmimet duhet të përcaktohen nga oferta dhe kërkesa. Përveç shqetësimeve kushtetuese, Oda Amerikane ka theksuar se ky vendim është miratuar nga një qeveri në detyrë, mandati i së cilës është ligjërish dhe institucionalisht i kufizuar. Qeveritë në detyrë pritet të sigurojnë vazhdimësinë e administrimit dhe të përmbahen nga miratimi i vendimeve substanciale politike që ndikojnë



materialisht aktivitetin ekonomik, strukturën e tregut apo të drejtat dhe detyrimet e aktorëve të sektorit privat. “Në këtë drejtim, Oda Amerikane tërheq vëmendjen te një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili ka riafirmuar autoritetin e kufizuar të institucioneve në detyrë për të miratuar akte normative me ndikim të gjerë ekonomik, si dhe ka urdhëruar detyrimin e

organeve ekzekutive për të vepruar në mënyrë të përmbytur dhe brenda kufizimeve të qarta ligjore. Ky vendim gjyqësor forcon më tej qëndrimin se vendimet me impakt të gjerë ekonomik, janë të rezervuara për qeveritë me mandat të plotë dhe legjitimitet demokratik e parlamentar. Përtej dimensioneve ligjore dhe institucionale, Oda Amerikane rithekson se çmimet e karburanteve ndikohen nga një gamë e gjerë faktorësh të jashtëm dhe strukturorë, përfshirë tregjet ndërkombëtare të naftës, zhvillimet gjeopolitike, zinxhirët rajonalë të furnizimit, kostot e transportit dhe sigurimit, luhatjet valutore dhe shpenzimet operative lokale. Kufizimet administrative të marzhave nuk i pasqyrojnë këto realitete dhe rrezikojnë të çrregullojnë tregun, të dekurajojnë konkurrencën dhe

të rrezikojnë sigurinë e furnizimit në një ekonomi shumë të varur nga importi, siç është Kosova”, është thënë në reagimin e OEAK-ut. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka bërë thirrje Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të rishqyrtojë menjëherë dhe të shfuqizojë vendimin për kontrollin administrativ të çmimeve. Kjo odë njëherësh ka kërkuar që kjo ministri të respektojë garancitë kushtetuese të ekonomisë së tregut të lirë dhe konkurrencës së lirë, të respektojë kufizimet ligjore që vlejnë për qeveritë në detyrë, si dhe t'i adresojë shqetësimet e tregut përmes transparencës, zbatimit të konkurrencës dhe dialogut me sektorin privat, në vend të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në çmime.

NË TIRANË NËNSHKRUHET MARRËVESHJE HISTORIKE PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Qendresa RAMA

TIRANË, 18 DHJETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veriut - Perëndimor, Unioni i Afaristëve “Vizioni-PMB” dhe Forumi i Bizneseve Ulqin nënshkruan një marrëveshje historike për bashkëpunim ekonomik kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo marrëveshje synon rritjen e bashkëpunimit ekonomik, forcimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet bizneseve vendore dhe atyre ndërkombëtare, si dhe bashkimin e kapaciteteve intelektuale dhe kapitale për të përshpejtuar integrimin drejt ekonomisë së lirë të Bashkimit Evropian. Kryetari i Aleancës Kosovare të



Bizneseve, Agim Shahini, theksoi se kjo marrëveshje përfaqëson një hap historik për organizatat ekonomike kombëtare. “Sot po bëjmë histori duke nënshkruar një

marrëveshje bashkëpunimi mes përfaqësuesve të pesë shteteve. Qëllimi ynë është rritja e shkëmbimeve tregtare, bashkimi i mendjes dhe kapitalit dhe ecja më e shpejtë drejt

ekonomisë së lirë evropiane. AKB merr përgjegjësinë që të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e bizneseve dhe punëtorëve të të gjitha kompanive që vijnë nga këto shtete në Kosovë, pranë institucioneve shtetërore dhe administrative”, ka thënë ai. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Nikolin Jaka, deklaroi: “Ne jemi në rrugëtimin e ekonomisë drejt Bashkimit Evropian dhe kemi nevojë për një bashkim të fortë ekonomik kombëtar për të rikuperuar hapat e humbur krahasuar me vendet e tjera. Kjo marrëveshje përfaqëson një fuqi dhe energji të re ekonomike e biznesore për Ballkanin Perëndimor”. Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut - Perëndimor, Nuhi Aliu, u shpreh: “Ne kemi qenë dhe do të jemi

gjithmonë për bashkëpunim kombëtar mes bizneseve tona”. Ndërsa kryetari i Unionit të Bizneseve të Luginës së Preshevës, Xhelal Mehmeti, theksoi: “Kjo marrëveshje është një mbështetje e madhe për Luginën e Preshevës dhe bizneset tona. Po realizohet një ëndërr për fuqizimin ekonomik kombëtar”. Kryetari i Forumit të Bizneseve Ulqin, Nazif Cungu, deklaroi: “Bizneset tona nuk mund të funksionojnë pa mbështetjen e Kosovës, Shqipërisë dhe gjithë rajonit. Jemi të kënaqur që nga ky moment jemi bashkë në këtë rrugë të përbashkët”. Në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Bordit të Forumit Mbarëshqiptar: Nebi Hoxha, Nagip Fejzi, Mendi Qyra, Besim Beqaj, Gjokë Uldedaj, Vullnet Haka, si dhe Lumnije Ajdini nga AKB.

Guvernatori Ismaili: Bashkëpunimi me akademinë, kyç për politika dhe vendimmarrje

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në aktivitetin akademik të prezantimit të projektit “DataSphere: Një platformë gjithëpërfshirëse e të dhënave për treguesit ekonomikë, strukturorë dhe socialë në Kosovë”, projekt i Universitetit “Hasan Prishtina” dhe Universitetit “Haxhi Zeka”, mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fjalën e tij para të pranishmëve, guvernatori Ismaili

vlerësoi projektin si një hap konkret drejt forcimit të kulturës së përdorimit të të dhënave dhe hulumtimit të bazuar në evidencë, si dhe si një shembull të suksesshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet akademisë dhe institucioneve publike. Sipas tij, iniciativa të tilla kontribuojnë drejtpërdrejt në avancimin e njohurive akademike, edukimin financiar dhe mbështetjen e politikëbërjes së informuar. Tutje, guvernatori Ismaili përmendi përkushtimin e vazhdueshëm të BQK-së për

zhvillimin, përmirësimin dhe publikimin e statistikave makroekonomike dhe financiare, si element kyç për monitorimin e zhvillimeve ekonomike dhe për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Duke vënë në pah rolin institucional, guvernatori Ismaili nënvizoi se BQK-ja publikon rregullisht statistika monetare dhe financiare, statistika të sektorit të jashtëm, buletine mujore, raporte tremujore, si dhe raporte kyçe si Raporti i Stabilitetit Financiar, Indikatorët e Stabilitetit Financiar dhe



Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë. Duke folur për projektin, guvernatori Ismaili vlerësoi veçanërisht strukturimin dhe

integrimin e statistikave nga burime të ndryshme institucionale dhe rritjen e qasjes për komunitetin akademik.

NJË ËNDËRR PËR PAQEN



Ndërsa një armëpushim i mbikëqyrur nga Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, në Rripin e Gazës hap perspektivën për një fund më të gjerë të dhunës në Lindjen e Mesme, Presidenti i Izraelit, Isaac Herzog, i tha Newsweek se ai ëndërron të festojë paqen me Princin e Kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman.

Duke folur në rezidencën e tij në Jerusalem, kreu i shtetit izraelit foli për mundësinë që sheh pas dy vitesh konflikti, gjatë të cilave vendi, nën drejtimin e Kryeministrit Benjamin Netanyahu, është përfshirë jo vetëm në luftimet më të përgjakshme me Hamasin dhe fraksione të tjera palestineze, por ka ndërmarrë gjithashtu sulme kundër Iranit, Hezbollahut në Liban, rebelëve Houthi në Jemen dhe forcave të tjera në Siri.

“Do të ishte ëndrra ime të mund të festoja paqen, për shembull, me Princin e Kurorës Mohammed bin Salman të Arabisë Saudite,” tha Herzog. “Sepse mendoj se djepi i Islamit, djepi i feve monoteiste dhe djepi i Judaizmit, së bashku, do ta ndryshonin botën.”

“Do të ishte një moment i jashtëzakonshëm për mua personalisht dhe për rajonin,” shtoi ai, duke theksuar se “ka ende shumë për të bërë”.

“Një çështje brezash”

Nuk është sekret që paqja me

Rijadin përfaqëson gurin e çmuar të kurorës në përpjekjet e Izraelit për të normalizuar pozicionin e tij në rajon.

Kërkesa është e lartë, pasi Arabia Saudite ka theksuar se një hap i tillë mund të ndërmerret vetëm si përgjigje ndaj një plani izraelit drejt shtetësisë palestineze, një çështje për të cilën Herzog shmang të shprehet drejtpërdrejt, për shkak të rolit të tij si kreu i shtetit.

Qëndrimet izraelite mbi mundësinë e rikthimit në negociata për pavarësinë palestineze janë ndikuar thellësisht nga lufta, duke sjellë një ndjenjë mosbesimi dhe traume që ndihet edhe nga palestinezët si pasojë e konfliktit, i cili vazhdon të marrë jetë edhe pas armëpushimit. Megjithatë, përfitimet nga një marrëveshje historike me Arabinë Saudite janë të konsiderueshme.

Mbretëria zë një vend unik në botën arabe dhe islame si vendlindja e Islamit dhe kujdestare e dy qyteteve të tij më të shenjta, Mekës dhe Medinës (i tretë është Jerusalem, që njëkohësisht është edhe vendi më i shenjtë për Judaizmin). Ndikimi i Arabisë Saudite është forcuar edhe më shumë vitet e fundit për shkak të ekonomisë së saj në rritje të shpejtë, peshës gjeopolitike në rritje dhe transformimit të vazhdueshëm të udhëhequr nga lideri de facto, Princi i Kurorës Mohammed bin Salman, i njohur gjerësisht si MBS.

Një marrëveshje normalizimi do të kishte potencialin të riformësonte pozicionin e Izraelit në një rajon ku ai ka qenë i përfshirë në një sërë konfliktesh që nga themelimi i tij në vitin 1948.

Megjithatë, Herzog vëren se shpeshherë, pas luftërave, janë hapur mundësi për paqe. “Në vitin 1948, kur u rrethuan dhe u sulmuam nga shtatë shtete, ishim plotësisht vetëm,” tha ai. “Nuk kishte askënd rreth nesh që kishte marrëdhënie me ne. Në vitin 1967, kur fituam një luftë pasi armiqtë kishin deklaruar se do të na hidhnin në det brenda pak ditësh, ky ishte një tjetër hap. Në vitin 1973 pati një tjetër luftë, një luftë e dhimbshme, por që çoi më pas në marrëveshjen e parë të paqes me Egjiptin.

Pas atij themeli të paqes me Egjiptin, pati edhe një luftë tjetër në Liban. Ngadalë, por me siguri, kjo çoi në Marrëveshjet e Oslos, pastaj në paqen me Jordaninë, më pas negociata dhe përpjekje të vazhdueshme, dhe një evolucion që sot i ka mundësuar Izraelit të ketë marrëdhënie me shumë vende myslimane përreth nesh.”

Me çdo konflikt të ri dhe me kalimin e pandalshëm të kohës, tha ai, njerëzit në Lindjen e Mesme kanë filluar ta pranojnë përhershmerinë e Izraelit, edhe përballë kërcënimeve të vazhdueshme, megjithëse me kosto të madhe. “Izraeli është këtu për të qëndruar përgjithmonë,” tha Herzog. “Ata duhet ta kuptojnë këtë.

Kërkon kohë. Është një çështje brezash.

Ata po e kuptojnë gjithnjë e më shumë, janë të interesuar arabët rreth nesh, miliona e qindra miliona njerëz. Ata lexojnë për ne, mësojnë për ne, janë të interesuar për ne. Ne jemi të ndërthurur me fqinjët tanë.

Mendoj se e ardhmja e këtij rajoni është dialogu mes hebreat dhe myslimanit. Shoh një fenomen të jashtëzakonshëm të liderëve myslimanë dhe aktivistëve myslimanë që vijnë nga e gjithë bota për të na takuar, për t'u lutur me ne dhe për të biseduar me ne.”

Një “mjeshtër i ri i lojës”

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në përpjekjet për normalizimin e Izraelit ishte nënshkrimi i Marrëveshjeve të Abrahamit në vitin 2020, një seri marrëveshjesh të udhëhequra nga Trumpi, përmes të cilave Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejni, Sudani dhe Maroku u bënë katër vendet e para arabe që vendosën marrëdhënie të plota diplomatike me Izraelin, pas marrëveshjeve me Egjiptin dhe Jordaninë.

Në atë kohë, një marrëveshje me Arabinë Saudite dukej e afërt. Por progresi u ngadalësua në vitin 2021 pas ndryshimit të administratës në Uashington dhe kërkesave të forta nga Rijadi, që përfshinin garanci mbrojtjeje nga SHBA,

bashkëpunim bërthamor dhe, më e ndërlikuar, një rrugë të qartë drejt shtetësisë palestineze.

Bisedimet vazhduan për dy vjet, shpesh në heshtje, deri në ngjarjen që do të trondiste çdo iluzion stabiliteti mbi status quo-n izraelito-palastineze. Sulmi i papritur i Hamasit më 7 tetor 2023 shënoi ditën më vdekjeprurëse në historinë e Izraelit, duke shkaktuar një luftë që ndezi tensionet rajonale dhe përfshiu Iranin dhe aleatët e tij në një konflikt me shtatë fronte.

Rreth 1,200 izraelitë u vranë në sulmin fillestar dhe 251 u rrëmbyen nga Hamasi, sipas autoriteteve izraelite. Qindra civilë dhe ushtarë izraelitë të tjerë janë vranë gjatë luftës. Ministria e Shëndetësisë e drejtuar nga Hamasi në Gaza vlerëson se rreth 70,000 palestinezë janë vranë gjatë konfliktit, ndërsa mijëra të tjerë raportohet se kanë humbur jetën nga sulmet izraelite në fronte të tjera, përfshirë Bregun Perëndimor, Libanin, Sirinë, Jemenin dhe Iranin.

Do të duheshin edhe dy vjet dhe rikthimi i Trump-it në pushtet që të mund të konsideroheshin seriozisht korniza të reja për rajonin. Herzog e përshkruan Trump-in si një “mjeshtër të ri të lojës”, duke iu referuar librit të vitit 2021 të Martin Indyk për Henry Kissinger-in, për rolin e tij në një “përpjekje të jashtëzakonshme” për të riformësuar Lindjen e Mesme pas luftës. / **Newsweek** – Bota.al

RIBOTIM

KOSOVA DHE SERBIA

KURRË MË BASHKË



Ismet SYLEJMANI

Këto ditë Sekretarja amerikane Condoleezza RICE, ashtu sikur Presidenti George W. Bush që deklaroi në Tiranë: “...se Kosova patjetër do të bëhet e pavarur...”, Ajo deklaroi në të përditshmen amerikane “USA Today” se: “Kosova dhe Serbia kurrë me bashkë”!

Condoleezza RICE 13.12. 2007, në të përditshmen amerikane “USA Today”!

Kosova dhe Serbia kurrë më parë në histori nuk kanë qenë bashkë, por padrejtësitë e mëdha ndaj popullit shqiptar bënë që Serbia ta aneksonte Kosovën dhe viset e saj, fuqitë e mëdha u vunë në anen serbe! Ose heshtën përballë pushtimit! Populli shqiptar i Kosovës dhe viseve të saj kurrë nuk u pajtua me realitetin e hidhur të krijuar, ku Kosova në vend të jetës së natyrshme e të përbashkët në kuadër të kufinjëve të brendshëm të Shqipërisë, u nda dhe dhunshëm u kalua nën juridiksion të ish-Jugosllavisë, përkatësisht Serbisë!

Gjatë gjithë kohës prej kur u aneksua Kosova nga Serbia e deri në qershor të 1999-s, kur Serbia u detyrua të largohej nga Kosova, populli shqiptar dhe bijte e bijat e tin më të mirë, luftën për kundershtimin e këtij realiteti, kurrë nuk e ndalën, por, përkjndrazi, me te gjitha mjetet e mundshme që disponuan i vunë në mbrojtje të jetës normale të popullit shqiptar, kundër shfarosjes e asimilimit të popullit shqiptar dhe të çlirimit të tij nga pushtuesit serb!

Nuk ka pëllëmbë të tokës së Kosovës heroike, e veçanërisht të Drenicës legjendare e të pamposhtur, që nuk e la me gjak, nga betejet e panumërta që u zhvilluan me armiqmëri serbë dhe veglat e tyre!

Janë të njohur për tërë popullin shqiptar bijtë e medhenjë të kombit që u vunë në ballë të misionit historik, të çlirimit të Kosovës dhe viseve të saj nga zgjedha serbe!


Regjimi serb nga Beogradi, i të gjitha periudhave dhe kohrave, në kontinuitet, kishte angazhuar ekspedita të tëra ndëshkuese për të shpartalluar kryengritje të shumta popullore, por edhe kishte stërvitur e trajnuar nëpër kampe të ndryshme kriminel e

shërbëtorë, për të vlarë e likuiduar luftëtarë të mëdhenjë e drejtues të lartë të çështjes kombëtare; heronjë të kombit si: Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Azem Bejta e Shotë Galica, Shaban Polluzha, Xheladin Hana, Fazli Grajçevci, Jusuf Gërvalla, Rexhep Malaj, Nuhi Berisha, Zija Shemsiu, Metush Krasniqi, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Ukshin Hoti etj!

Serbia kishte mbushur tej mase të gjitha kampet e përqëndrimit dhe burgjet e veta me djemtë dhe vajzat më të mira të popullit shqiptar të Kosovës dhe viseve të saj!

Por sa më shumë që zhvilloheshin gjyqet politike dhe dënosheshin të rinjtë dhe te rejtat shqiptare të Kosovës dhe viseve të saj, aq më shumë rritej urrejtja për pushtuesit e Kosovës dhe shtoej besimi në fitoren e popullit shqiptar.

Bëhej gjithçka që



pos SHBA-së dhe Anglisë!

Lufta kundër Serbisë pushtuese që zhvilloi populli shqiptar jo vetëm i Kosovës dhe viseve të saj, përfundoi me çlirimin e Kosovës dhe kapitullimin e ushtrisë serbe dhe djegien nga bombardimet e NATO-s, të mbi gjysmës së objekteve vitale të shtetit serb anembanë Serbisë!

NATO-ja, sikur të ishte forca ajrore shqiptare, bombardoi agjencinë famëkeqe të lajmeve TANJUG!

NATO bombardoi dhe dogji në flakë ngrohtoren në qendër të Beogradit, u'a këputi urat mbi Danub, e shkatërroi rafinerinë e naftës, shkriu reparte të tëra të Fabrikës së Armëve dhe Municioneve në Kragujevac e Nish, në hakmarrje për masakrat mbi popullin shqiptar dhe të UÇK-së, por edhe ndihmës së ofruar nga NATO-ja në Kosovë, kapitulloi kriminelin e çetniku Millosheviq, përfaqësuesi më në zë i kuzhinës antishqiptare serbe!

Gjakpërësia Millosheviq ishte vazhduesi më besnik dhe zbatuesi më i famshëm i projekteve antishqiptare të Akademisë Serbe të Shkencave! Populli shqiptar i Kosovës edhe kur ishte nën pushtimin serb kurrë nuk e pushoi luftën për ta larguar Serbinë nga Kosova,

kurse tani që më ajo nuk është në Kosovë, po tentoi te rikthehet do ta presë ashtu sikur ka arritur ta largojë - me luftë të armatosur, mbrojtëse e çlirimtare, ku nuk do të mungojë ndihma dhe përkrahja e madhe e aleateve tanë të fuqishëm!

Por aleatët tanë të mëdhenjë SHBA-ja dhe Anglia, por edhe disa vende të tjera të Bashkimit Evropian, janë të vendosur që ëndrrën e popullit shqiptar të Kosovës për pavarësinë ta mbështesin deri në fund dhe ta bëjnë realitet!

Këto ditë Sekretarja amerikane Condoleezza RICE, ashtu sikur kryetari George W.Bush që deklaroi në Tiranë: se Kosova patjetër do të bëhet e pavarur, ajo deklaroi në të përditshmen amerikane “USA Today” se: “Kosova dhe Serbia kurrë me bashkë”!

Amerikanët deklarojnë se me Sërbinë Kosova kurrë më bashkë!, po ne shqiptarët me luftë e barot e kemi dëshmuar një gjë të tillë!


Rusia duhet ta dijë se ajo më nuk ka gjasa të ketë interesa strategjike në Kosovë nëpërmjet Serbisë.

Kurse ndikimi Rus në Kosovë ka perënduar bashkë me largimin e Serbisë nga Kosova!

Zonja RICE, lufta heroike e UÇK-së dhe bombardimet e NATO-s përfundimisht e kanë vulosur ndarjen e Kosovës nga Sërbia!

Deklarimit Tuaj nuk kemi çfarë t'i shtojmë, vetëm e përshëndesim me ngrohtësi! Populli shqiptar do t'ju jetë mirënjohës përgjithmonë.

Prishtinë, 17 Dhjetor 2007!



Superkupa e Kosovës zhvillohet më 25 janar në Antalia

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) ka publikuar datën e zhvillimit të Superkupës së Kosovës mes Dritës dhe Prishtinës. Sipas FFK-së, ndeshja e Superkupës së Kosovës do të zhvillohet më 25 janar 2026 (e diel), me fillim nga ora 14:30, sipas orës lokale

të Turqisë (12:30 sipas kohës në Kosovë). Ndeshja do të luhet në stadiumin "Mardan Palace" në Antalia, ku do të përballen FC Drita, si kampione e Kosovës dhe FC Prishtina, si fituesja e Kupës së Kosovës për edicionin 2024/25. Duke marrë parasysh

faktin se të dyja ekipet do të jenë të angazhuara në fazën përgatitore dimërore nga 15 deri më 30 janar 2026 në Antalia, Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës, në përputhje me agjendën e klubeve, ka marrë vendim që Superkupa e

Kosovës të zhvillohet në këtë periudhë dhe në këtë lokacion. Ndryshe, kjo është hera e katërt që finalja e Superkupës së Kosovës zhvillohet në Antalia të Turqisë, pasi më parë kanë luajtur edhe Drita-Prishtina, Llapi-Ballkani dhe Prishtina-Ballkani.



ADEMI TAKOHET ME AMBASADORIN E KOSOVËS NË DOHA, DISKUTOJNË PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT ME KATARIN

DOHA, 18 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka bërë me dije se gjatë qëndrimit në Doha, në kuadër të aktiviteteve të FIFA-s, ka vizituar Ambasadën e Kosovës në Katar.

Ademi treguar se me ambasadorin e kësaj ambasade, Faud Morina, ka biseduar për

raportet në mes të Kosovës e Katarit dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në fushën sportive. "Gjatë qëndrimit tim në Doha për aktivitetet e FIFA-s, pata kënaqësinë të vizitoj Ambasadën e Republikës së Kosovës në Katar, ku u pritja nga Ambasadori Fuad Morina.

Diskutuam mbi raportet miqësore ndërmjet Kosovës dhe Katarit, si dhe mbi mundësitë për të thelluar bashkëpunimin në fushën sportive me këtë shtet mik. Bashkëpunimi me institucionet tona dhe lidhjet ndërkombëtare janë çelësi për zhvillimin e futbollit tonë!", ka shkruar Ademi në "Facebook".

LOJËRAT MESDHETARE, 50 MILIONË EURO PËR RENOVIMIN E PALLATIT TË RINISË

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ministri në detyrë i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se Pallati i Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë do t'i nënshtrohet një rinovimi të plotë me vlerë prej 50 milionë eurosh, në kuadër të përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare. Investimi përfshin edhe sallën e djegur, duke synuar

funksionalizimin e plotë të objektit në shërbim të sportistëve, artistëve dhe të rinjve të vendit. "50 milionë euro për Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Rinovim total, përfshirë sallën e djegur, në përgatitje për Lojërat Mesdhetare, dhe në shërbim të sportistëve, artistëve e të rinjve tanë", ka deklaruar Çeku në "Facebook".

Ai ka njoftuar se në bazë të marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime, tashmë janë angazhuar studiot projektuese që do të hartojnë projektin e rijetësimit të Pallatit, hap i domosdoshëm për nisjen e punimeve.

Sipas ministrit, ekspertiza profesionale vendore dhe ndërkombëtare

është bërë bashkë për të ndërtuar një model modernizimi dhe funksionalizimi të plotë të kësaj ndërtese ikonike të kryeqytetit. "Po krijojmë një model të ri për Pallatin e Rinisë, që i përgjigjet nevojave bashkëkohore dhe i kthen këtij objekti rolin që i takon në jetën sportive, kulturore dhe rinore të vendit", ka shkruar Çeku.



PSG-ja, FITUESE E KUPËS NDËRKONTINENTALE

DOHA, 18 DHJETOR - Paris Saint-Germain (PSG) është shpallur fitues i Kupës Ndërkontinentale, duke mposhtur Flamengon në finale pas një serie dramatike penaltish, pasi koha e rregullt dhe vazhdimet nuk ka dhënë fitues. PSG-ja e ka nisur ndeshjen me ritëm të lartë, duke krijuar disa raste që në minutat e para. Një gol i Fabian Ruiz në minutën e 9-të është anuluar pas rishikimit me VAR, pasi topi kishte dalë jashtë fushës gjatë aksionit. Goli i



parë i ligjshëm ka ardhur në minutën e 38-të, kur Khvicha Kvaratskhelia ka përfutur nga një pasim perfekt dhe e ka dërguar topin në rrjetë, duke i dhënë epërsinë PSG-së 1-0. Pjesa e parë është karakterizuar nga ndërhyrje të forta dhe kartonë të verdhë për të dyja skuadrat.

Në pjesën e dytë, Flamengo ka reaguar dhe ka shtuar presionin. Momenti kyç ka ardhur në minutën e 60-të, kur pas një faulli në zonë, gjyqtari Ismail Elfath

është thirrur nga VAR-i dhe ka akorduar një penallti për brazilianët. Në serinë e penaltive, më të saktë kanë dalë lojtarët e PSG, duke fituar 2-1 dhe duke ngritur trofeun e Kupës Ndërkontinentale për klubin francez. Ky triumf vjen pas një ndeshjeje të balancuar dhe dramatike, që dëshmoi fuqinë dhe qetësinë e lojtarëve të PSG-së në momentet vendimtare. PSG-ja me këtë triumf, ka fituar trofeun e gjashtë sezonal.

Nico Williams e pret Real Madridin

MADRID, 18 DHJETOR - Nico Williams është i vendosur të largohet nga Athletic Bilbao në fund të sezonit dhe synimi i tij kryesor mbetet Real Madrid.

Pavarësisht interesimit të fortë nga disa klube të Premier League, veçanërisht Arsenali, anëtori spanjoll ka zgjedhur të presë ofertën nga "Los

Blancos".

Real Madrid po monitoron situatën në treg dhe Nico shihet si një opsion serioz për të ardhmen, sidomos në rast

ndryshimesh në repartin ofensivë. Deri atëherë, lojtari mbetet i fokusuar te Bilbao, duke pritur thirrjen që mund të ndryshojë karrierën e tij.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Qendrën e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU “Luigj Gurakuqi” në fshatin Sankoc të Drenasit, do të organizohet debat publik nga “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Drenas, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

Zoom:<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwurm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Rec Kos” Sh.p.k., Komuna Fushë Kosovë, për Pëlqim Mjedisor, Qendrën e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Blerim Lladrovci B.I. “Dyqani i Pavarur Tregtar Pelikan” pronar Blerim Lladrovci, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811546970 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da Blerim Lladrovci B.I. “Dyqani i Pavarur Tregtar Pelikan” Blerim Lladrovci donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811546970 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the Blerim Lladrovci B.I. “Dyqani i Pavarur Tregtar Pelikan” Blerim Lladrovci, has come to the decision to quit its business: 811546970 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Crafted Devsolutions” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812268226 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Crafted Devsolutions” L.L.C. i Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812268226 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Crafted Devsolutions” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812268226 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ideal Podrimja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

